

MARRËVESHJE PËR NËNSHKRIMIN E KUOTËS

Sot me datë 10.09.2022 lidhet kjo Marrëveshje për nënshkrimin e kuotës ("Marrëveshja") nga dhe midis palëve te mëposhtme:

- "**NOA Development**" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar ne përputhje me legjislacionin e Republikës se Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L42203032I, me seli Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i saj Znj. **Eranda Nepravishta**; (me tej referuar si "**Shoqëria**");

dhe

- "**ZIP CLOUD**" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L61531022M, me seli Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i saj Znj. **Eranda Nepravishta** (me tej referuar si "**ZIP**")

Shoqëria dhe ZIP do të referohen këtu e në vijim si "**Palët**", ndërsa secila prej tyre do të referohet në veçanti si "**Palë**".

NDËRKOHE:

- A. Që nga data e kësaj Marrëveshje, kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 100,000 (njëqind mijë) Lekë të përfaqësuara nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë, e emetuar dhe e paguar plotësisht ("**Kuota Ekzistuese**").
- B. Aktualisht ekziston një detyrim i pakthyer ende nga Kredimarrësi kundrejt Kredidhënësit në shumën totale prej 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë (më tej "**Detyrimi Ekzistues**"). Kjo vlerë përbëhet nga:
 1. Marreveshja e Kredisë së lidhur në datë 28.12.2021 ndërmjet "ZIP CLOUD" SHPK (në cilësinë e "**Kredidhënësit**") dhe "NOA Development" SHPK (në cilësinë e "**Kredimarrësit**") mbi bazën e së cilës Kredimarrësi ka marrë nga

Kredidhënësi një kredi në shumën totale prej 1,800,000 Euro (Një milionë e tetëqind mijë Euro) apo 217,368,000 (Dyqind e shtatëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetëtë mijë) Lekë.

2. Ndërsa diferenca në vlerë prej 12,509,069 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë është kriuar si rezultat i marrëdhënieve të biznesit mes palëve Kredidhënës dhe Kredimarrësit.
- C. Për të shlyer detyrimin e saj, Shoqëria synon të rrisë kapitalin e saj në vlerën prej **229,877,069** (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë (pra në vlerën e Detyrimit Ekzistues) nëpërmjet emetimit të një kuote të re për ZIP-in, me një vlerë nominale prej 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë, që do të përfaqësojë **99.96%** (nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e gjashtë përqind) të të gjithë kapitalit themeltar të Shoqërisë pas rritjes së kapitalit, me të njëjtat të drejta si Kuota Ekzistuese ("Kuota e ZIP").
- D. Sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje, ZIP ka rënë dakord që nënshkrimi, zotërimi dhe shlyerja e Kuotës së ZIP do të realizohet duke konvertuar në kapital Detyrimin Ekzistues në vlerën 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, që Shoqëria ka kundrejt ZIP sipas Marrëveshjes së Kredisë të përmendur në shkronjën A më lart.
- E. Është qëllimi i Palëve që në përfundim të transaksionit të mësipërm ortakët e Shoqërisë të zotërojnë numrin e mëposhtëm të kuotave të emetuara dhe të paguara të Shoqërisë në përmasat e mëposhtme:
 - Z. **Gentian SULA** të zotërojë 1 (një) kuotë në vlerën prej 100,000 lekë e cila përfaqëson **0.04%** të kapitalit; dhe
 - "ZIP CLOUD" SHPK të zotërojë 1 (një) kuotë në vlerën prej 229,877,069 lekë e cila përfaqëson **99.96%** të kapitalit.
- F. Palët dëshirojnë që me anë të kësaj Marrëveshjeje të rregullojnë kushtet sipas të cilave do të realizohet emetimi i Kuotës së ZIP dhe shlyrja e saj me konvertimin e Detyrimit Ekzistues.

Për sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë:



1. MARRËVESHJA PËR NËNSHKRIMIN

- 1.1 Me anë të kësaj Marrëveshje, me qëllimin për të shlyer Detyrimin Ekzistues, Shoqëria bie dakord të emetojë Kuotën e ZIP duke rritur kapitalin e saj në vlerën e Detyrimit Ekzistues.
- 1.2 ZIP bie dakord të nënshkruajë Kuotën e ZIP në datën e kësaj Marrëveshje, në vlerën e Detyrimit Ekzistues.
- 1.3 Për shmangien e çdo dyshimi, nënshkrimi, zotërimi dhe shlyerja e Kuotës së ZIP do të realizohet duke konvertuar në kapital Detyrimin Ekzistues në vlerën 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, që Shoqëria ka kundrejt ZIP CLOUD sipas Marrëveshjes së Kredisë të përmendur në shkronjën A të parashikimeve fillestare më lart.
- 1.4 Kontributi i ZIP në kapitalin e rritur të Shoqërisë që do të përfaqësohet nga Kuota e ZIP [në vlerën 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë], do të konsiderohet i shlyer duke u kompensuar me Detyrimin Ekzistues që Shoqëria ka ndaj ZIP [me të njëjtën vlerë 229,877,069 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë].
- 1.5 Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, ZIP përfiton titullin dhe pronësinë e Kuotës së ZIP duke u bërë ortaku tjetër i Shoqërisë i cili zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 99,96% të kapitalit të Shoqërisë.
- 1.6 Për shmangien e çdo dyshimi, fitimi i titullit dhe pronësisë së Kuotës së ZIP dhe gjithashtu i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhën me Kuotën, si e drejta përfitimi dhe e drejta e votës, por edhe çdo e drejte tjetër do të konsiderohet se ka ndodhur në datën e kësaj Marrëveshjeje.

2. REGJISTRIMI

- 2.1 Shoqëria do të bëjë që ndryshimet e mëposhtme të regjistrohen dhe reflektohen menjëherë në Regjistrin e Kuotave të Shoqërisë:
 - Z. **Gentian SULA** zotëron 1 (një) kuotë në vlerën prej 100,000 lekë e cila përfaqëson **0.04%** të kapitalit; dhe
 - "ZIP CLOUD" SHPK zotëron 1 (një) kuotë në vlerën prej 229,877,069 lekë e cila përfaqëson **99.96%** të kapitalit.

2.2 Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 30 ditëve nga data e kësaj Marrëveshje, Shoqëria do të sigurojë regjistrimin e kësaj Marrëveshje, të Kuotës së ZIP dhe të zmadhimit përkatës të kapitalit, në Qendrën Kombëtare të Biznesit. ZIP do të ofrojë të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm që Shoqëria të përbushë një detyrim të tillë më kërkesën e parë të Shoqërisë, e cili gjithashtu përfshin ose mund të përfshijë (nëse kërkohet për shkak të zhvillimit të mëtejshëm), dhënien e deklaratave të çdo lloji ose hyrjen në një aneks të kësaj marrëveshjeje ose marrjen e ndonjë veprimi tjeter të kërkuar për regjistrimin e transaksionit siç përcaktohet në këtë Marrëveshje.

3. PËRFAQËSIMET, GARANCITË DHE DETYRIMET E PALËVE

3.1 Shoqëria përfaqëson dhe i garanton ZIP,

- se është një person juridik i themeluar dhe ekzistues sipas ligjit Shqiptar dhe se ka marrë paraprakisht kompetencat dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të dhënë përfaqësimet dhe garancitë në këtë Marrëveshje dhe për të ndërmarrë ose për të mundësuar ndërmarrjen e detyrimeve dhe të marrëveshjeve shoqëruese të kësaj Marrëveshje. Asnjë pëlqim i asnjë Pale të tretë nuk kërkohet në lidhje me përbushjen e detyrimeve të tyre. Kjo Marrëveshje përbën detyrimet e autorizuara, të vlefshme dhe ligjërisht të detyrueshme të Shoqërisë ose të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj;
- derisa Kuota e ZIP të jetë nënshkruar, paguar plotësisht dhe rritja përkatëse e kapitalit të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Shoqëria është e detyruar që të mos:
 - emetojë kuota të tjera;
 - rrisë kapitalin e saj;
 - ndryshojë vlerën nominale të, ose të drejtat e bashkëlidhura kuotave të saj; ose
 - të ndërmarrë çdo veprim tjeter me ndryshimin e statutit të saj ose nëpërmjet riorganizimit, konsolidimit, shitjes së kapitalit, bashkimit ose shitjes së aktiveve, ose ndryshe që mund të rezultojë në një pakësim të interesit në Shoqërinë që përfaqësohet nga Kuota e ZIP.

3.2 ZIP përfaqëson dhe i garanton Shoqërisë, se është një person juridik i themeluar dhe ekzistues sipas ligjit Shqiptar dhe se ka marrë paraprakisht kompetencat dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të dhënë përfaqësimet dhe garancitë në këtë Marrëveshje dhe për të ndërmarrë ose për të mundësuar ndërmarrjen e detyrimeve dhe të marrëveshjeve shoqëruese të kësaj Marrëveshje. Asnjë pëlqim i asnjë Pale të tretë nuk kërkohet në lidhje me përbushjen e detyrimeve të tyre. Kjo

Marrëveshje përbën detyrimet e autorizuara, të vlefshme dhe ligjërisht të detyrueshme të ZIP ose të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj.

4. TRANSFERIMET DHE ZVENDËSIMET NË TITULL

- 4.1 Kjo Marrëveshje dhe të drejtat, detyrimet, përfitimet dhe mjetet juridikë të krijuara këtu nuk janë të caktueshme dhe as të transferueshme tek ndonjë person ose subjekt tjetër juridik pa pëlqimin paraprak më shkrim të Palëve në këtë Marrëveshje. Çdo caktim ose transferim i pretenduar të ndonjë person ose subjekt juridik pa pëlqimin paraprak më shkrim të Palëve do të jete i pavlefshëm dhe nuk ka efekt juridik.
- 4.2 Kjo Marrëveshje do të jete e detyrueshme për trashëgimtarët, ekzekutuesit, pasardhësit në titull, përfaqësuesit e autorizuar dhe të emëruarit e lejuara të Palëve në këtë Marrëveshje.

5. TAKSA, TARIFA LIGJORE, ETJ.

- 5.1 Shoqëria do të përballojë taksat, kostot dhe tarifat e avokateve dhe kostot e tjera të transaksionit dhe tarifat e pësuara për ose në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Çdo taksë e aplikueshme në lidhje më transaksionin e parashikuar në këtë Marrëveshje do të paguhet nga Shoqëria në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.2 Kur është e aplikueshme, tarifat administrative dhe të gjitha tarifat dhe shpenzimet e nevojshme ose të përshtatshme për regjistrimin e kësaj Marrëveshje, Kuotës së ZIP dhe zmadhimit përkatës të kapitalit në përputhje me këtë Marrëveshje do të përballohen nga Shoqëria.

6. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

- 6.1 Kjo Marrëveshje dhe interpretimi e zbatimi i kushteve dhe dispozitave të saj do të rregullohen nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 6.2 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo çështje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e saj, do t'i referohet dhe do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyçësor Tiranë.

7. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE TËRËSIA E MARRËVESHJES

- 7.1 Nëse ndonjë kusht ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, e paligjshme ose e paaftë për t'u zbatuar në përputhje më ligjin, të gjitha kushtet dhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë pa u prekur ose paragjykuar nga termi i pavlefshëm ose i paligjshëm ose i pazbatueshëm.
- 7.2 Kjo Marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen midis Palëve dhe zëvendëson dhe shuan të gjitha diskutimet, korrespondencat, negociatat, draftet, marrëveshjet, premtimet, zotimet, garancitë, përfaqësimet dhe mirëkuptimet e mëparshme ndërmjet tyre, qofshin ato të shkruara apo me gojë, në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje.

8. NDRYSHIMET

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jete i vlefshëm përvèç nëse behet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët (ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar).

9. TË DREJTAT E PALËVE TË TRETA

Më përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, askush tjetër përvèç Palëve në këtë Marrëveshje, pasardhësi(t) e tyre me titull dhe përfaqësuesi(t) e autorizuar nuk do të kenë ndonjë të drejte të zbatojnë ndonjë nga parashikimet e saj.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët vendosen nënshkrimet e tyre në datën e shkruar më sipër.

PALËT KONTRAKTUESE

SHOQËRIA

Per "NOA Development" SH.P.K
Administratori
Eranda Nepravishta

Eranda Nepravishta



ZIP

Per "ZIP CLOUD" SH.P.K
Administratori
Eranda Nepravishta

Eranda Nepravishta



'KONTRATË HUAJE

Neni 1050 e në vijim Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Sot, në Tiranë, më datën 28.12.2021, nënshkruhet kjo kontratë huaje ("Kontrata"), ndërmjet:

ZIP Cloud sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) L61531022M, me seli në adresën: seli Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, katër 2, përfaqësuar nga Eranda Nepravishta. Në vijim cilësuar "**Huadhënësi**"

NOA Development sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) L42203032I, me seli në adresën: seli Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, katër 2, përfaqësuar nga Erjona Dyrmyshi. Në vijim cilësuar "**Huamarrësi**"

Palët si më sipër me vullnet të plotë dhe të lirë bien dakord dhe nënshkruajnë si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është financimi i nevojave të Huamarrësit me fonde që do të lëvrohen nga ana e Huadhënësit, sipas përcaktiveve të bëra në kete kontrate.
- 1.2 Shuma e financimit do të shlyhet sipas rregullave të përcaktuara nga palët në këtë Kontrate.

Neni 2

Kohëzgjatja

- 2.1 Kjo Kontratë ka një kohëzgjatje prej 12 (*dymbëdhjete*) muaj dhe mund të zgjatet edhe me 12 (*dymbëdhjetë*) muaj të tjera nëse nuk plotësohet kushti i shlyerjes sipas nenit 4 me poshtë. Kontrata do të prodhojë pasoja juridike nga momenti i lëvrimit të shumës, ose pjesë të saj, deri në përfundim të afatit si më sipër treguar.

Neni 3

Financimi dhe kushtet e lëvrimit

- 3.1 Shuma prej **1.800.000 Euro** (Një milionë e tetëqind mijë Euro) do të lëvrohet nga Huadhënësi në llogarinë e **NOA Development** në një këst sipas kërkesës së Huamarrësit.

Neni 4

Interesat dhe shlyerja e principalit

- 4.1 Huaja do te jepet me interes 2% e vlerës totale.
- 4.2 Shlyerja e shumës së financimit do të kryhet brenda 12 (*dymbëdhjete*) muajsh.



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit

- 5.1 Huamarrësi merr përsipër dhe detyrohet t'i paguaje Huadhënësit, vlerën e financimit ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate
- 5.2 Huamarrësi ka të drejtën e marres së fondeve dhe shfrytëzimit të tyre sipas nevojave të tij.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Huadhënësit

- 6.1 Huadhënësi është i detyruar të lëvroje shumën e përcaktuar ne kete kontrate, në favor të Huamarrësit.
- 6.2 Huadhënësi detyrohet t'i lëshoje dëftese pagese Huamarrësit në momentin e shlyerjes.

Neni 7

Përfundimi i Kontratës

Kontrata konsiderohet e përfunduar në momentin që Huadhënësi shlyen detyrimin e plotë sipas kësaj kontrate.

Neni 8

Forca madhore

- 8.1 Në rast se palët e kësaj Kontrate do të janë në kushtet e forcave madhore, e cila e bën të pamundur realizimin e objektit të kësaj Kontrate, palët bien dakord qe kjo Kontrate do të pushojë së prodhuari pasoja juridike për sa kohë që forcat madhore do të ekzistojnë.
- 8.2 Me pushimin e forcave madhore, palët do të fillojnë serish të zbatojnë dispozitat e kësaj Kontrate nën kushtet dhe afatet kohore që janë të përfshira në të.
- 8.3 Në rast se të tilla forca madhore do të vazhdojnë për një periudhe kohore që i kalon 180 ditë, Huadhënësi do të ketë të drejtë të zgjidhe këtë Kontratë si dhe të kërkojë nga Huamarrësi te gjithë shumën e financimit apo të çdo shume tjetër që ai ka lëvruar si pasojë e kësaj Kontrate.
- 8.4 Me “**forca madhore**” nënkuuptohet rasti i cili nuk mund të kontrollohet nga palët si dhe nuk mund të korrigohet nga këto palë; i cili lind pa pasur si shkak gabimet apo neglizhencën e palëve dhe që këto palë, nga ana logjike e rrjedhjes së fakteve nuk mund ta kenë shkaktuar atë, duke përshirë këtu pa kufizim, situata të tillë si: zjarr, përblyje, tërmete, shpërthim eksplozivi, luftërat, situata të cilat pengojnë pjesërisht apo tërësisht përbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate nga ana e palëve.

Neni 9

Ligji i zbatueshëm

- 9.1 Kjo Kontrate është hartuar në baze të legjislacionit shqiptar dhe dispozitave ligjore të Kodit Civil të Republikës se Shqipërisë.
- 9.2 Çdo dispozite e kësaj Kontrate apo përbajtja e saj, do te trajtohet dhe interpretohet duke marrë në konsideratë qëllimin qe i ka shtyre palët ta lidhin atë.

- 9.3 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate mund të behet me anë të një miratimi me shkrim të palëve mbi bazën e vullnetit të tyre të lirë. Për çdo gjë palët do të njoftojnë njëra tjetrën në adresat përkatëse.

Neni 10

Gjykata kompetente

Kjo Kontrate si dhe të drejtat dhe detyrimet e lidhura me palët e kësaj Kontrate, do ti nënshtrohet interpretimit në përputhje me legjisacionin shqiptar. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi midis palëve në zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë kompetencë e Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11

Të ndryshme

- 11.1 Çdo njoftim, aplikim, apo komunikim që do të jepet në kuadër të kësaj kontrate midis palëve do të kryhet në formë shkresore dhe do të dërgohen me faks ose me poste me lajmërim marrje në adresën e palës tjetër.
- 11.2 Të gjithë dokumentet që do të sigurohen apo komunikimet që do të jepen apo kryhen në kuadër të kësaj Kontrate do të janë në gjuhën shqipe.
- 11.3 Asnjë nga palët nuk ka të drejtën që të transferojë të drejtat apo detyrimet e tij nën këtë Kontratë, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.
- 11.4 Dispozitat e kësaj Kontrate do të jene të detyrueshme në mënyre të pavarur nga njëra tjetra dhe pavlefshmëria e njërsës prej tyre nuk do të sjell si pasojë pavlefshmërinë e dispozitave te tjera.

Kjo Kontratë hartohet ne 3 (*tre*) ekzemplarë origjinal.

PALËT

HUADHËNËSI

ZIP CLOUD SH.P.K

Francesca Nepram Shqip

ZIP CLOUD
NUIS: 61531022M
Tirane - Albania

HUAMARRËSI

NOA DEVELOPMENT SH.P.K

Ergjona Djemjeku

NOA Development
Sh.p.k.
TIRANE

**VENDIM I ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË
"ZIP CLOUD" SH.P.K.**

Sot më datë 23.09.2022, Z. Gentian Sula, shtetas shqiptar, lindur në Burrel, më 09.03.1983, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I30309064B, zotërues i kuotës e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë:

"ZIP CLOUD" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L61531022M, me seli Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë, Shqipëri, ("Shoqëria"),

me ane të këtij akti:

VENDOSI


1. Të miratojë nënshkrimin e kuotës së re të shoqërisë "NOA Development" SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar ne përputhje me legjislacionin e Republikës se Shqipërisë, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër NUIS L42203032I, me seli Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë, Shqipëri, në vlerën prej **229,877,069** (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, e cila do të përfaqësojë 99.96% të kapitalit të shoqërisë "NOA Development" SH.P.K, sipas Aktit të përgatitur nga Audituesi Ligjor.
2. Nënshkrimi, zotërimi dhe shlyerja e kuotës së re në shoqërinë "NOA Development" SH.P.K. do të realizohet duke konvertuar në kapital detyrimin ekzistues në vlerën **229,877,069** (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, që "NOA Development" SH.P.K. ka kundrejt Shoqërisë sipas Marrëveshjes së Kredisë datë 28.12.2021 dhe sipas marrëdhënieve të tjera të biznesit mes palëve, **të reflektuara në Aktin e përgatitur nga Audituesi Ligjor**.
3. Kontributi i ZIP CLOUD në kapitalin e rritur të Shoqërisë që përfaqësohet nga kuota e re me vlerë **229,877,069** (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, do të konsiderohet i shlyer duke u kompensuar me detyrimin që "NOA Development" SH.P.K. ka kundrejt Shoqërisë me të njëjtën vlerë pra, **229,877,069** (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
4. Të miratojë lidhjen e marrëveshjes përkatëse që do të nënshkruhet ndërmjet "NOA Development" SH.P.K. dhe "ZIP CLOUD" SHPK për nënshkrimin e kuotës se re në shoqërinë "NOA Development" SH.P.K.



5. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë për të nënshkruar marrëveshjen përkatëse të përmendorur në pikën 4 të këtij vendimi, çdo dokument tjetër të nevojshëm apo që lidhet me atë marrëveshje, si dhe për të kryer pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) të gjitha depozitimet dhe regjistrimet përkatëse në lidhje me këtë vendim, si dhe çfarëdolloj dokumentacioni mbështetës të kërkuar nga legjislacioni i zbatueshëm. Administratori i Shoqërisë gëzon të drejtën të autorizojë palë të treta për të ndërmarrë këto veprime.

Vendim i Ortakut të Vetëm të shoqërisë **"ZIP CLOUD" SH.P.K.**

Z. Gentian Sula



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gentian Sula". Below the signature is a long, thin, horizontal line, likely a part of the document's layout.

**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN****Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)**
(Vetem per perdom zyrtar)

| |
|------------------------------|
| (2) Periudha tatimore |
| 21-A |

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):**(3) L61531022M****Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:****(4) ZIP CLOUD****Emri Mbiemri i Personit Fizik:****(5)****Adresa:****(6) Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake,
Kati 2, Kodi Postar 1000****Qyteti/Komuna/Rrethi:****Tirana, Tirane, Tirane****Numri Telefonit:****(7)**

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plete ose ka ndryshuar

*Llogaritja e rezultatit**Te ardhurat dhe shpenzimet**Të ushtrimit**Tatimore*

| | |
|----------------|---------------------------------|
| (8/9) | Te ardhurat |
| (10/11) | Shpenzimet |
| (12) | Shpenzimet e pazbritshme |

| | | | |
|-------------|--------------------|-------------|--------------------|
| (8) | 383,094,102 | (9) | 383,094,102 |
| (10) | 4,835,855 | (11) | 4,835,855 |
| | | (12) | 2,227,293 |

Rezultati

| | |
|----------------|--|
| (13/14) | Humbja |
| (15/16) | Fitimi |
| (17) | Humbje e mbartur |
| (18) | Fitimi i tatueshem neto (16-17) |

| | | | |
|-------------|--------------------|-------------|--------------------|
| (13) | 0 | (14) | 0 |
| (15) | 378,258,247 | (16) | 380,485,540 |
| | | (17) | 0 |
| | | (18) | 380,485,540 |

Llogaritja e tatum fitimit

| | |
|-------------|--|
| (19) | Tatum fitimi me shkallen tatimore standarte |
| (20) | Tatum fitimi me perqindje te tjera |
| (21) | Tatum fitimi me perqindje te tjera |
| (22) | Tatum fitimi (19+20+21) |
| (23) | Tatum fitimi i shtyre |
| (24) | Tatum Fitimi i detyrueshëm për t'u paguar |

| | |
|-------------|-------------------|
| (19) | 40,748,631 |
| (20) | 5,441,400 |
| (21) | 0 |
| (22) | 46,190,031 |
| (23) | 0 |
| (24) | 46,190,031 |